



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.0.1-2014-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014

Prishtinë, Qershor 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, ndërsa mund të ndërmerre edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për t'i kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të komunës së Prishtinës në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Bujar Sejdiu , i mbështetur nga Luljeta Morina (Udhëheqës Ekipi), Kreshnike Haziri dhe Qëndresa Sogojeva.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	9
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	11
3 Rekomandimet e vitit paraprak.....	15
4 Qeverisja.....	16
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP.....	35
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak	38
Shtojca III: Përgjigja e Menaxhmentit ndaj të gjeturave të ZAP-it.....	42


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të komunës së Prishtinës për vitin 2014 - i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falenderoj Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 13/09/2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opiniononi

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të Opinioneve të dhëna nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare paraqesin *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim të Çështjes* dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se pasuria e trashëguar prej 2,500,000,000€ dhe pasuritë e përfituara gjatë vitit 2014 në shumë 416,778€ nuk ishin regjistruar në SIMFK.


Çështje tjera


Për shkak të keqklasifikimit të shpenzimeve, investimet kapitale në PVF ishin mbideklaruar për 17,322€ ndërsa shpenzimet për mallra dhe shërbime ishin nën-deklaruar 15,505€ dhe subvencionet për 1,817€.


(SNISA 200/1706: Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore për Kryetarin janë:







Përgjigjja e menaxhmentit - auditimi 2014

Të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport janë marrë në konsideratë nga Kryetari. Përgjigjet e Kryetarit, lidhur me çështjet për të cilat nuk kemi mundur të pajtohemi janë dhënë në detaje në Aneksin III.

Ne e marrim si punë të kryer që Kryetari :

- Të diskutojë raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Gjatë muajit janar/shkurt 2016 të inicojë diskutimet në Asamblenë Komunale lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF 2015 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e menaxhmentit të komunës së Prishtinës të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shpreh opinionin:

- nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim efektiv financiar dhe kontroll, si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien efikase të outputeve cilësore operationale. Kjo, për shembull, mund të jetë një aktivitet monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operationale. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e ndërmjetme të auditimit, ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para prodhimit të PVF-ve dhe para auditimit final. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët, do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe teste substanciale të shoqëruara me to vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF-ve merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Kryetari i komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshinë një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklaratat kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Konkluzioni i përgjithshëm

Edhe pse kishte nevojë për korrigjim të disa gabimeve, cilësia e PVF-ve ishte në përgjithësi e mirë, përveç raportimit të pasurive. Kjo është çështje materiale jashtë parimit të raportimit në bazë të parasë së gatshme dhe si e tillë ka rezultuar me Theksim të Çështjes. Kjo tregon se deklaratat e bërë nga Kryetari i Komunës dhe ZKF, e të cilës i referohemi më lart, nuk ishte e saktë në të gjitha aspektet. Obligimet tjera për raportim që nuk ndërlidhen me PVF-të ishin përmbushur.

2.1 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare paraqesin *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim të Çështjes* dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se pasuria e trashëguar prej 2,500,000,000€ dhe pasuritë e përfituara gjatë vitit 2014 në shumë 416,778€ nuk ishin regjistruar në SIMFK.

Çështje tjera

Për shkak të keqklasifikimit të shpenzimeve, investimet kapitale në PVF ishin mbideklaruar për 17,322€ ndërsa shpenzimet për mallra dhe shërbime ishin nën-deklaruar 15,505€ dhe subvencionet për 1,817€.

(SNISA 200/1706: Opinioni i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes)

2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit të datës 13.10.2014, është identifikuar një rrezik domethënëse në PVF lidhur me plotësinë e pasurive. Ky është një rrezik që mund të rezultojë në modifikim të opinionit.

Rreziku i identifikuar

Çështja 1 - Mos regjistrimi i të gjitha pasurive mund të rezultojë në nënvlerësim material të vlerave të pasurive në PVF

Përgjigja dhe gjetjet e auditimit

Ne shqyrtoam veprimet e menaxhmentit dhe udhëzimet e aplikuara në lidhje me regjistrimin e pasurive. Ne e vlerësojmë punën që është duke u bërë me mbështetjen nga projekti DEMOS për rishikimin kadastral dhe identifikimin e pronave, por kjo punë ende nuk është përfunduar. Në Memon e auditimit të ndërmjetëm, ne i kemi dhënë këshilla menaxhmentit për veprimet e nevojshme për të siguruar që pasuritë e prezentuara në PVF janë të plota. Megjithatë, menaxhmenti nuk e ka përfunduar rishikimin në proces i cili potencialisht mund të ofroj regjistër të plotë të pasurive të komunës. Si rezultat i kësaj, pasuria prej 2,5 miliardë euro mbetet e paregjistruar në SIMFK plus vlera e pasurisë ende të pavlerësuar.

Rekomandimi 1 Prioritet i Lartë - Kryetari i komunës duhet të siguroj vazhdimin e procesit të regjistrimit të të gjitha pasurive. Një rol kyç në këtë proces duhet të ketë Drejtoria e Kadastrit, duke siguruar/ofruar të gjitha të dhënat mbi pronat publike në posedim të komunës. Bazuar në këtë, një komision i veçantë duhet të bëjë një vlerësim dhe një raport t'ia dorëzoj zyrtarit të pasurive për t'i proceduar regjistrimet e duhura në sistemin e SIMFK (moduli i pasurive). Në fund të vitit duhet të kryhet inventarizimi i tërësishëm për të konfirmuar ekzistencën e pasurive (në veçanti të pasurive të luajtshme) si dhe të funksionalizoj përdorimin e modulit E-pasuria për të konfirmuar saktësinë dhe plotësinë e pasurive nën 1,000€. Të gjitha aktivitetet duhet të kryhen para se PVF-të e vitit 2015 të jenë dorëzuar.

2.3 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Përshkrimi

Komuna e Prishtinës duhet të jetë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048;
- Kërkesat e buxhetit;
- Raportet tremujore duke i përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntëmujore;
- Raportet operative (të performancës); dhe
- Nëse draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit është dorëzuar më kohë.

Në PVF finale kishte nevojë të bëhen disa korigjime financiare dhe disa përmirësime. Gabimet në draft PVF ishin për shkak të ndryshimit të të dhënave në SIMFK gjatë përgatitjes së PVF-ve, dhe janë paraqitur në vijim:

Çështja 2 - Përgatitja e Pasqyrave Financiare - Prioritet i Lartë

E gjetura Për shkak të procesit joefektiv të rishikimit nga menaxhmenti, i aplikuar për PVF, ne kemi identifikuar:

- Në pasqyrën e pranimeve dhe pagesave bashkëfinancimet nga organizatat tjera buxhetore në shumë 799,000€ ishin paraqitur si pagesa nga palët e treta;
- Shënimi 11 nuk përmbante shpalosjet lidhur me vlerën e shpenzimeve operationale të raportuara si investime kapitale në shumë 17,322€;

- Shënimi 16 - fondet nga donatorët ishin nënvlerësuar për 141,000€; dhe
- Në shënimin 37, shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit nuk ishte e saktë për 22,000,000€.

Edhe pse janë bërë korrigjimet e mësipërme, shpalosjet e pasurive në PVF-të ende përmbajnë gabime materiale, siç është pasqyruar në pjesën 2.2 më sipër.

Rreziku

PVF-të të cilat nuk janë subjekt i një rishikimi të nivelit të lartë nga menaxhmenti potencialisht do të përfshijnë gabime materiale të cilat shpiejnë tek një opinion i modifikuar. Më tutje, PVF-të që përfshijnë gabime mund të konsiderohen si jo të besueshme, duke rezultuar kështu në dëmtim të kredibilitetit të raportimit.

Rekomandimi 2

Kryetari i komunës duhet të sigurojë që plani i hartimit të PVF-ve për 2015 të përfshijë një rishikim kritik nga menaxhmenti të draft pasqyrave, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Kryetari dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet përveç nëse në draft PVF janë zbatuar kontrollet e nevojshme.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Edhe pse komuna e ka përgatitur një Plan Veprimi për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga ZAP, niveli i realizimit të këtij plani ishte tejet i ulët.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2013 ka rezultuar me 16 rekomandime kryesore dhe komuna ka përkatitur një Plan Veprimi për zbatimin e këtyre rekomandimeve.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2014, tri (3) rekomandime ishin adresuar plotësisht, katër (4) ishin adresuar pjesërisht dhe nëntë (9) nuk ishin adresuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 3 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i Lartë

E gjetura Përkundër shumë mangësive të identifikuara në vitin paraprak dhe rekomandimeve të dhëna për përmirësime, vetëm një numër i vogël i i veprimeve ishin marrë për të adresuar rekomandimet e vitit të kaluar. Kjo, sepse komuna nuk ka zbatuar ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar zbatimin e rekomandimeve të AP-së në pajtim me planin e përgatitur për veprim.

Rreziku Mos adresimi i plotë i rekomandimeve ka rezultuar në dobësi të vazhdueshme në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në:

- regjistra jo të plotë të pasurisë;
- menaxhim të dobët të të hyrave dhe shpenzimeve që ka rezultuar në realizim të dobët të të hyrave, në realizim të dobët të buxhetit dhe në vlerë të dobët për paranë; dhe
- sistem të dobët të auditimit të brendshëm dhe duke i ofruar menaxhmentit siguri minimale për nivelet e kontrollit.

Rekomandimi 3 Kryetari i komunës duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga ZAP-i dhe atyre të paadresuara, të zbatohet me staf përgjegjës dhe me fokus fillestar në ato të një rëndësie më të madhe.

4 Qeverisja

Konkluzioni i përgjithshëm

Aspektet kyçe të një kornize të mirëfilltë qeverisëse që mund të aplikohen nga komuna janë:

- Menaxhimi i rrezikut- ku komuna ende nuk ka vendosur procedura formale dhe të dokumentuara për identifikim dhe menaxhim të rreziqeve, të cilat do ta zvogëlonin ekspozimin ndaj rreziqeve të ndërlidhura me arritjen e objektivave të komunës;
- Raportimi i brendshëm si bazë për monitorim efektiv të aktiviteteve dhe arritje të objektivave strategjike;
- Vetëvlerësimi - ku komuna nuk ka aplikuar vetëvlerësimin në pajtim me procedurat MFK-ës. Një vetëvlerësim objektiv do ta ndihmonte menaxhmentin t'i identifikoj dobësitë dhe ta përmirësoj ambientin e kontrollit; dhe
- Sistemi i Auditimit të Brendshëm-aty ku një komitet auditimi efektiv nuk ka funksionuar gjatë tërë vitit 2014.

Si të tilla, aranzhimet e përgjithshme të qeverisjes kanë nevojë të forcohen. Ne kemi gjetur dobësi edhe në menaxhimin e sistemeve kryesore si:

- Nivel i ulët i ekzekutimit të buxhetit, kryesisht për shkak të dobësive në buxhet;
- Dobësi në menaxhimin e të hyrave kryesisht për shkak të dobësive në raportim e brendshëm që ka rezultuar me nivel të ulët të inkasimit; dhe
- Dobësi në menaxhimin e shpenzimeve për shkak të dobësive në monitorim sistematik e që ka rezultuar me shumë projekte të perealizuara.

Megjithatë, ne gjithashtu kemi identifikuar disa veprime pozitive të aplikuara nga komuna në vitin 2014, duke përfshirë rritjen e transparencës në vendim-marrje dhe ekzekutim; trajtimin e ndërtimeve pa leje, edhe pse kjo ka ndikuar në uljen e nivelit të të hyrave vetjake; dhe performancën e mirë në menaxhimin e subvencioneve. Nga aspekti i ofrimit të shërbimeve, Komuna e Prishtinës ka aplikuar një orar të ri pune të shërbimeve për qytetarët duke iu mundësuar atyre të kenë qasje të pandërprerë në këto shërbime deri në 17:30.

4.1 Qeverisja e mirë

Përshkrim

Qeverisja ka të bëjë me sistemin përmes të cilit menaxhohen dhe kontrollohen organizatat. Qeverisja efektive kërkon planifikim, monitorim dhe aranzhime të rrepta raportuese të cilat në mënyrë të qartë i adresojnë rreziqet operationale dhe strategjike me të cilat përballlet një organizatë.

Rekomandimet

Çështja 4 - Aranzhimet e Përgjithshme për Qeverisje - Prioritet i Lartë

E gjetura Ekziston kontroll i dobët financiar nga menaxhmenti i lartë mbi shpenzimet dhe të hyrat. Takimet e bordit të drejtorëve nuk dokumentohen me procesverbale (por vetëm me video incizime) sepse nuk ka fokus mbi procese të vendimmarrjes të dokumentuara qartë. Për shkak të mungesës së këtij dokumentimi, si pjesë e qasjes sonë të auditimit, ne nuk jemi mbështetur në kontrollet e menaxhmentit mbi raportimin.

Kërkesat e MFK-së për aplikim të vetëvlerësimit dhe për regjistra të rrezikut janë adresuar vetëm pjesërisht, sepse komuna nuk e njeh plotësisht rëndësinë e tyre si mjete për ta mbështetur menaxhimin efektiv. Nuk ka regjistër formal të rrezikut apo proces formal të menaxhimit të rrezikut dhe vetëvlerësimi nuk është bërë bazuar në një shqyrtim mjaft të detajuar. Kërkesa ligjore për një raport të performancës për 2013 gjithashtu nuk është përmbushur për shkak të mungesës së llogaridhënies ndaj akterëve kyç të saj.

Gjatë vitit 2014 nuk ka funksionuar Komiteti i Auditimit për shkak të njohës së varfër të rëndësisë së këtij komiteti për aranzhimet efektive të qeverisjes së mirë. Komuna e ka themeluar Komitetin e Auditimit (KA) në nëntor të 2014. Mirëpo, ky komitet nuk ka ndërmarrë ndonjë aktivitet të rëndësishëm deri në fund të vitit.

Rreziku Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi i cilësisë së dobët e zvogëlojnë efikasitetin e menaxhimit operacional dhe financiar brenda në komunë dhe mund të rezultojnë në humbje të mundshme financiare. Mungesa e një Komiteti të Auditimit efektiv redukton fokusin dhe ndikimin e aktivitetit të auditimit të brendshëm si dhe redukton sigurinë që auditimi i brendshëm ia ofron menaxhmentit.

Rekomandimi 4 Kryetari i komunës duhet të sigurojë një rishikim të kualitetit të aranzhimeve ekzistuese të qeverisjes/llogaridhënies në Komunë dhe kërkesat e ndërlidhura për raportim të tyre. Kërkesat e pa plotësuara duhet të zbatohen deri në fund të vitit 2015, duke përfshirë edhe statutin e Komitetit të Auditimit për të siguruar efektivitetin e tij duke demonstruar pranë Asamblesë Komunale ndryshimin e praktikave për të siguruar menaxhim efektiv operacional të komunës si një bazë për arritjen e objektivave strategjike.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i Buxhetit

Përshkrimi

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Burimet e Fondeve:	63,443,190	82,022,857	56,801,207	68,692,532	57,694,113
Granti i Qeverisë -Buxheti	39,124,940	42,673,260	40,116,243	40,020,715	39,843,922
Të bartura nga viti paraprak ² -		14,612,164	5,903,886	16,563,303	8,354,450
Të hyrat vetanake ³	24,318,250	24,318,250	10,718,580	11,906,906	9,335,688
Donacionet e brendshme		17,314	4,800	14,079	102,365
Donacionet e jashtme		401,869	57,698	187,529	57,688

Buxheti final ishte më i lartë se buxheti fillestar për 18,579,667€ si rezultat i:

- Rritjes së grantit qeveritar në shumë 3,548,320€;
- Barjtes së të hyrave vetanake nga viti paraprak në shumë 14,612,164€; dhe
- Donacioneve të brendshme dhe të jashtme në shumë 419,183€.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është përshtatur vazhdimisht nga MeF.

² Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Në vitin 2014, komuna ka shpenzuar 56,801,207€ apo 69% të buxhetit final krahasuar me 81% në vitin 2013. Shkalla e realizimit të buxhetit nuk është e kënaqshme dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	63,443,190	82,022,857	56,801,207	68,692,532	57,694,113
Pagat dhe Mëditjet	22,237,317	25,810,032	25,610,137	22,165,668	22,048,920
Mallrat dhe Shërbimet	10,282,442	11,340,912	7,872,882	7,434,683	7,136,850
Shërbimet komunale	1,760,431	1,760,431	1,609,849	1,551,636	1,548,000
Subvencionet dhe Transferet	1,595,000	5,665,000	4,791,642	2,591,286	1,407,690
Investimet Kapitale	27,568,000	37,446,482	16,916,697	34,949,259	25,552,653

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Pavarësisht rritjes së buxhetit për shpenzime kapitale gjatë vitit, vetëm 45% e buxhetit ishte shpenzuar. Kjo ka shkaktuar vonesa në inicimin e proceduarve të prokurimit, mungesë të projekteve për ndërtimin e rrugëve dhe çështje/probleme pronësore;
- Rritja e buxhetit për paga dhe mëditje për 3,572,715€ është rezultat i vendimit për rritjen e pagave për 25% nga muaji prill. Kjo rritje ishte financuar nga granti qeveritar në shumë 3,548,320€ dhe nga të hyrat e bartura në shumë 24,395€;
- Pavarësisht zvoglimit të buxhetit për 15%, është shpenzuar vetëm 69% e buxhetit për Mallra dhe Shërbime. Edhe pse buxheti është rritur nga të hyrat vetjake, komuna nuk ka asnjë justifikim të duhur për këtë rritje.;
- Buxheti për Subvencione dhe Transfere është rritur për 4,070,000€ për ta mbështetur sistemin e ngrohjes qendrore të qytetit përmes ko-gjenerimit. Rritja është bërë përmes transferimit të mjeteve nga kategoritë e tjera të shpenzimeve, kryesisht nga Investimet Kapitale. Megjithatë, ekzekutimi i buxhetit final prej 85% për këtë kategori tregon rënie prej 9% në krahasim me vitin paraprak; dhe

- Vetëm 15% e buxhetit për Donacione është shpenzuar. Komuna ka dështuar t'i përdorë donacionet për shkak të pamundësisë për të vendosur kontrolle buxhetore mbi projektet e financuara nga donatorë të brendshëm dhe të jashtëm.

Tabela 3. Të hyrat vetjake për buxhetin e komunës - ekzekutimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Pranimet	2013 Pranimet	2012 Pranimet
Të hyrat vetjake	24,318,250	24,318,250	19,904,414	21,748,614	23,160,238

Në vitin 2014 janë mbledhur 82% e të hyrave vetjake të planifikuara ku bëjnë pjesë të hyrat nga lejet e ndërtimit, tatimi në pronë, participimet dhe taksat që ndërlidhen me toka në shumë 18,395,677€ dhe 1,508,737€ nga të hyrat nga gjobat e trafikut, gjykatat dhe agjencia e pyjeve.

Shuma e përgjithshme e të hyrave ishte për 9% më e ulët se në vitin 2013 e që pasqyron një rënie të vazhdueshme gjatë 3 viteve të fundit. Rënia gjatë këtij viti në veçanti ka ndodhur për shkak të reduktimit të numrit të lejeve të lëshuara për ndërtim. Në kontekst të nivelit të buxhetit fillestar, zvogëlimi i tij, pjesërisht, ishte për shkak të politikave të reja të qeverisjes së re lokale.

Rekomandimet

Çështja 5 - Ekzekutim i ulët i buxhetit dhe shfrytëzim i ulët i të hyrave vetjake - Prioritet i Lartë

E gjetura Nivelet e ulëta të ekzekutimit të buxhetit pasqyrojnë planifikim të dobët dhe projeksione joreale të të hyrave. Pavarësisht buxhetit të nënshpenzuar, obligimet u rritën për 36,854€. Edhe pse një pjesë e suficitit ishte jashtë kontrollit të menaxhmentit aktual për shkak se buxheti dhe projektet janë miratuar nga qeverisja e mëparshme, niveli i ekzekutimit të shpenzimeve tjera ka mundur të jetë më i lartë.

Vetëm 16,622,466€ ose 48% nga 34,516,578€ e të hyrave vetjake në dispozicion janë shpenzuar gjatë vitit 2014. Shuma 17,894,112€ do të barten në vitin 2015. Edhe kjo ka pasqyruar planifikim të dobët.

Komuna kishte parashikuar 4,600,000€ nga tatimi në pronë por në buxhetin e aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, planifikimi i këtyre të hyrave ishte 3,450,441€ ndërsa në fillim të vitit ka faturuar 5,393,566€. Janë mbledhur 5,649,337€ ose 163% e të hyrave të planifikuara nga tatimi në pronë. Këto të hyra përfshijnë edhe borxhe nga vitet e kaluara. Përkundër ngritjes së inkasimit, ky planifikim, edhe pse përcaktohet pjesërisht nga qarkoret buxhetore të cilat e përcaktojnë

tavanin (kufirin e lartë), nuk pasqyron një projeksion të duhur të të hyrave nga ky burim

Rreziku Dobësitë në planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit e zvoglojnë efektivitetin e planeve të komunës dhe do të rezultojnë në mos arritjen e objektivave komunale. Niveli i ulët i ekzekutimit mund të rezultojë në reduktimin e granteve qeveritare dhe në financimin e obligimeve të vitit aktual nga buxheti i vitit të ardhshëm. Mos përdorimi i të hyrave vetjake mund të rezultojë në ngecje të realizimit të projekteve të financuara nga ky burim. Projektioni i të hyrave më i ulët se shumica e faturuar do të rezultojë në planifikimin joreal dhe në humbje të mundshme për komunën.

Rekomandimi 5 Kryetari i komunës duhet të sigurojë një monitorim sistematik të performancës buxhetore në baza mujore si dhe t'i identifikojë dhe adresojë pengesat në përmirësimin e nivelit të ekzekutimit të buxhetit dhe në përdorimin efektiv të të hyrave vetjake. Nëse supozimet fillestare buxhetore janë të pasakta, ato duhet të rishikohen në pozitën e buxhetit final. Kryetari i komunës duhet poashtu të iniciojë një analizim të arsyeve të mospërputhjes midis planifikimit dhe faturimit për tatimin në pronë dhe të sigurojë që planifikimi i të hyrave është i bazuar në vlerësime reale të detyrimeve tatimore.

Çështja 6 - Keqklasifikimi i shpenzimeve - Prioritet i Mesëm

E gjetura Rishikimi ynë ka identifikuar 2 raste ku komuna i ka keq klasifikuar shpenzimet. Kjo ka ndodhur për shkak të dështimit të Komunës që t'iu përmbahet Rregullës Financiare (RrF) 01/2013:

- shpenzimi i 15,505€ për "trajtimin e qenve endacakë", është planifikuar dhe klasifikuar si investim kapital; dhe
- pagesa prej 1,817€ me vendim të gjykatës për pensione dhe paga jubilarë është bërë nga kategoria e subvencioneve.

Rreziku Klasifikimi i gabuar i pagesave mund të rezultojë në mbivlerësim/nënvlerësim të kategorive të shpenzimeve. Kjo mund të çojë në keqkuptime për pozitën financiare të komunës dhe nëse vlера është materiale, mund të rezultojë në Modifikim të Opinionit.

Rekomandimi 6 Kryetari i komunës duhet të sigurojë që arsyet e keqklasifikimeve do të identifikohen dhe t'i forcojë kontrollet në mënyrë që të gjitha shpenzimet planifikohen dhe klasifikohen në kodet/kategoritë e duhura me synimin që këto të paraqiten drejtë në PVF.

4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

Përshkrimi

Burimet kryesore të të hyrave vetjake të komunës së Prishtinës janë nga lejet e ndërtimit, tatimit në pronë, taksat administrative, taksat për regjistrimin e automjeteve dhe taksa për shfrytëzimin e pronës.

Rekomandimet

Çështja 7 - Menaxhimi i të hyrave nga tatimi në pronë - Prioritet i Mesëm

E gjetura Në pesë raste komuna kishte lëshuar vërtetime për tatimin në pronë për tatimpagues që nuk kishin përmbushur obligimet për taksa. Shuma totale e obligimit për tatim në pronë në këto raste ishte 20,798€. Kjo situatë është paraqitur si rezultat i rishikimit të dobët nga menaxhmenti në procesin e lëshimit të vërtetimeve për tatim.

Rreziku Lëshimi i vërtetime për tatim qytetarëve të cilët nuk kanë bërë pagesa për tatim në pronë krijon mundësi për mashtrim dhe korrupsion, është në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe rezulton në trajtim jo të barabartë të qytetarëve.

Rekomandimi 7 Kryetari i komunës duhet t'i analizojë arsyet se pse janë lëshuar vërtetime për tatim në mungesë të pagesave për tatim dhe t'i forcojë kontrollet duke siguruar që vërtetimet do të lëshohen vetëm pas përmbushjes së plotë të kriterëve për pagesë.

Çështja 8 - Pronat e dhëna me qira - Prioritet i Lartë

E gjetura Komuna nuk ka vendosur kontrole adekuate të menaxhimit të qiradhënieve dhe pronave. Komuna ka dështuar në zbatimin e rregulloreve përkatëse.

Nga 91 qiramarrës të pronës komunale/banesave: 23 nuk kishin fare kontratë për shfrytëzim të pronës; 43 kanë paguar 0.30€/m² sipas një rregulloreje të vitit 2011 e që nuk paraqet çmimin real të tregut; dhe 48 shfrytëzues të tjerë (asambleistë aktual dhe të kaluar) paguajnë një tarifë prej 10% të pagës së shfrytëzuesit e që nuk është në pajtim me rregulloren për tarifa dhe ngarkesa. Për më tepër, komuna nuk ka mundur të ofrojë informata mbi të hyrat dhe formën e pagesave për shfrytëzimin e këtyre pronave komunale.

Rreziku Kontrollat e dobëta mbi qiradhëniet dhe pronat mund të rezultojnë në reduktim ose humbje të të hyrave dhe mund të rezultojnë në mashtrim dhe korrupsion. Mungesa e informacionit të plotë mbi pranimet dhe pagesat, nëse konsiderohet si një çështje materiale mund të ndikojë në opinionin e auditimit.

Rekomandimi 8 Kryetari i komunës duhet t'i përcaktojë arsyet për kontrollat e dobëta mbi menaxhimin e të hyrave nga qiraja dhe t'i forcojë kontrollat për të siguruar që të gjitha qiratë të pasqyrojnë kontratat formale dhe çmimet e tregut deri në fund të vitit 2015. Një listë e plotë dhe e saktë e të gjithë shfrytëzuesve me shumat që i kanë borxh komunës duhet të përpilohet dhe duhet identifikuar kërkesat për pagesa dhe të njëjtat të implementohen.

Çështja 9 - Lejet e ndërtimit - Prioritet i Lartë

E gjetura Përkundër faktit që komuna ka përmirësuar menaxhimin e lejeve të ndërtimit, dobësitë e identifikuara në kontrolle për shkak se komuna ka dështuar në aplikimin e rregullave të brendshme:

- Në një rast të shpronësimit të tokës, kundërvlera e cila i është kompensuar pronarit e ka tejkaluar 20% të hapësirës së lejuar për ndërtim shtesë në m²; dhe
- Në rastet e rishikuara, komuna ka aplikuar tarifën 10€ për aplikim për leje ndërtimi, në vend që ta aplikoj tarifën e duhur prej 50€.

Rreziku Aplikimi i gabuar i tarifave për leje ndërtimi dhe i rregulloreve i shkakton komunës humbje financiare dhe rezulton në shkelje të rregullave dhe standardeve të planifikimit hapësinor.

Rekomandimi 9 Kryetari i komunës duhet të përcaktojë se pse janë paraqitur dështimet e identifikuara në lidhje me lejet për ndërtim dhe duhet të implementoj kontrolle të përmirësuara për të siguruar që në të ardhmen, rregullat dhe tarifatat aplikohen drejtë.

4.4 Shpenzimet

4.4.1 Prokurimi

Përshkrimi

Rregullat e prokurimit kanë për qëllim të sigurojnë që fondet publike të arrijnë vlerën për para përmes aplikimit transparent dhe efikas të tyre. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në prokurimin publik. Kjo përfshin edhe kërkesat për t'i zvogluar rreziqet në lidhje me vonesat në përfundimin e punëve, shmangien e konfliktit të interesave dhe ofertave jo të plota dhe arritjes së vlerës për para.

Në vitin 2014 në total janë zbatuar 270 procedura të prokurimit (në vlerë 17,323,954€).

Edhe përkundër rritjes së transparencës dhe të aranzhimeve tjera për arritjen e vlerës për para, kontrollet mbi prokurimin nuk ishin efektive në mënyrë konstante gjatë vitit 2014.

Rekomandimet

Çështja 10 - Dobësi sistematike në prokurim - Prioritet i Lartë

E gjetura Nga rishikimi i 23 kontratave dhe 76 pagesave, ne kemi identifikuar një sërë dobësish sistematike të cilat pasqyrojnë kontrolle menaxheriale joefektive dhe dështime të komunës për t'iu përmbajtur kërkesave legislative si në vijim:

- Komuna nuk ka aplikuar kontrolle efektive për të siguruar punë cilësore dhe vlerë për para. Si pasojë, në 8 raste për ndërtim të infrastrukturës rrugore, komuna i kishte filluar procedurat e prokurimit duke u bazuar vetëm në parashikimet financiare, pa hartimin e projekteve paraprake siç parashihet me Ligjin e Ndërtimit. Në një projekt mungonte elaborati mbi shpimet gjeomekanike;
- Në dy raste, për shkak të shkëputjes së kontratës, komuna ka shfrytëzuar kontraktorë të tjerë, duke anashkaluar procedurat e prokurimit. Për shembull: kontrata për furnizim me naftë për shkolla, duke shkaktuar humbje financiare në vlerë prej 10,674€ si pasojë e çmimit më të lartë; dhe
- Komuna kishte paguar pesë fatura në shumë totale 2,779€ për mirëmbajtje dhe servisim të automjeteve, pa pasur aprovim nga zyrtari përgjegjës për menaxhimin e automjeteve.

Rreziku Mos ndjekja e procedurave të prokurimit ka rezultuar në humbje financiare dhe mund të rezultojë edhe në pagesa të parregullta. Mungesa e projekteve për ndërtimin/riparimin e rrugëve mund të rezultojë në cilësi të dobët të punëve dhe në vlerë të ulët për para dhe të shoqërohet me rrezikun e shkeljës së standardeve për ndërtim dhe në përsëritje të punëve.

Rekomandimi 10 Kryetari i komunës duhet të përcaktoj se pse nuk janë ndjekur kërkesat për prokurim në rastet e identifikuara dhe të aplikoj kontrole të përmirësuara që të siguroj që dobësitë sistematike janë identifikuar dhe janë adresuar. Të gjitha ndërtimet duhet të bëhen vetëm nëse ekzistojnë projekte të duhura ndërtimi.

Çështja 11 - Dobësitë jo-sistematike të prokurimit - Prioritet i Mesëm

E gjetura Për shkak të dështimit të komunës për t'ju përmbajtur kërkesave rregullative dhe për të zbatuar praktika të mira janë identifikuar dobësi të tjera të prokurimit si në vijim:

- Për projektin “Rikonstruimi i objektit të shkollës Elena Gjika dhe shkollave tjera”- Lot III, në dosjen e tenderit ishte kërkuar garancion bankar për 180 ditë. Me kontratë ishte shpërblyer operatori i cili kishte ofruar garancionin e ekzekutimit vetëm për 90 ditë. Për projektin e njejtë (Lot II), komuna nuk kishte bërë paramasë të saktë dhe disa pozicione të punëve të parapara nuk ishin kryer. Komuna nuk ishte në gjendje të dokumentojë se cilat pozicione nuk ishin përfunduar; dhe
- Me rastin e dekorimit të qytetit për festat e fund vitit, komuna nuk kishte aplikuar procedurën e hapur të tenderimit. Me procedurë të kuotimit të çmimeve ishte lidhur një kontratë për “Furnizim me bredha” në vlerë prej 9,480€ dhe një tjetër “Dekorimi i Shesheve” në vlerë prej 7,538€.

Rreziku Dështimi që procedurat e prokurimit dhe udhëzuesit përkatës të aplikohen me konsistencë mund të rezultojë në mos-realizim të kontratës dhe në kosto shtesë për komunën, në pagesa të gabuara dhe të parregullta dhe në vlerë të dobët për para.

Rekomandimi 11 Kryetari i komunës duhet të inicojë një rishikim të praktikave të aplikuara të prokurimit në këto raste dhe të zbatojë kontrolle të forcuara të cilat sigurojnë se prokurimet e sigurojnë aftësinë e kontraktorëve për t'i përfunduar kontratat; faturat i pasqyrojnë shumat aktuale të borxheve; dhe që nuk është aplikuar kuotimi i çmimeve - me përjashtim të rrethanave të caktuara.

Çështja 12 - Trajtimi i bashkëfinancimeve - Prioritet i Mesëm

E gjetura Në maj 2014, komuna dhe Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal kanë nënshkruar një memorandum për projektin "Ndërtimi i stadiumit në Hajvali". Komuna do të financonte 70,000€ ndërsa Ministria 80,000€ (subjekt i përfundimit të projektit brenda vitit fiskal 2014). Kontrata me operatorin ekonomik për këtë projekt u nënshkrua në dhjetor 2014, por nuk është bërë asnjë punë/pagesë në këtë projekt deri në fund të vitit fiskal 2014. Si pasojë, memorandumimi është anuluar. Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk i ka menaxhuar në mënyrë aktive kërkesat për prokurim sipas planit kohor të caktuar nga Marrëveshja për financim.

Rreziku Vonesa në përfundimin e projektit ka rezultuar në humbje të fondeve potenciale të financimit prej 80,000€. Kjo, nëse shihet se komuna nuk është në gjendje t'i implemetoj projektet me kohë, mund të rezultojë edhe në humbje të bashkë-financimeve në të ardhmen.

Rekomandimi 12 Kryetari i komunës duhet të përcaktojë se pse kanë dështuar aranzhimet për menaxhim të projektit në këtë rast dhe të zbatojë aranzhime të përmirësuara në lidhje me bashkëfinancimet për të siguruar se nuk do ketë humbje të financimeve nga jashtë.

4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrim

Shpenzimet tjera janë shpenzimet që nuk kalojnë përmes procesit të prokurimit. Këtu bëjnë pjesë komunalitë, drekat zyrtare, udhëtimet zyrtare etj. Pashtu ndërlidhen me shpenzimet në lidhje me disa marrëveshje të bashkë-financimit.

Rekomandimet

Çështja 13 - Avanset - Prioritet i Lartë

E gjetura Komuna ia ka transferuar IOM-it 60,000€ për "Ndërtimin e ndërtesës kopshtit për fëmijë në Arbëri", i cili do të realizohet gjatë vitit 2015. Transferi ka qenë një avans i bazuar në Memorandumin mes komunës dhe IOM-it si bashkë-financues. Përveç kësaj, komuna nuk ka planifikuar fonde për këtë projekt. Transferimi ishte nga fondet e planifikuara për projektin për ndërtimin e shkollës në Arbëri. Komunës nuk i janë dhënë informacione të detajuara nga monitorimi. Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk i ka ndjekur rregulloret për pagesa.

Rreziku Avanset e pambështetura nga kontrata efektive mund të rezultojnë në humbje financiare për komunën. Pagesat për donatorët, të pambështetura nga informata të hollësishme për bazën e shpenzimeve, mund të rezultojnë në dështim për ti arritur objektivat dhe potencialisht mund të konsiderohen si pagesa të parregullta.

Rekomandimi 13 Kryetari i komunës duhet të përcaktojë se pse ky avans nuk ka qenë subjekt i kontrolleve të përshtatshme në përputhje me kërkesat ligjore dhe duhet t'i forcoj kontrollet për të siguruar që një veprim i tillë nuk përsëritet. Marrëveshjet për bashkë-financim duhet t'i pasqyrojnë marrëveshjet kontraktuale të cilat komunës i ofrojnë monitorimin efektiv për progresin e projektit.

Çështja 14 - Drekat zyrtare dhe udhëtimet zyrtare - Prioritet i Mesëm

E gjetura Rishikimi ynë ka identifikuar dy pagesa për dreka zyrtare në vlerë 1,595€, me ç'rast përveç faturës nuk kishte informata të mjaftueshme për qëllimin e drekës zyrtare dhe/apo listën e pjesëmarrësve. Kjo kishte ndodhur pasi që komuna nuk kishte arritur t'i respektojë plotësisht kërkesat e rregulloreve mbi pagesat.

Rreziku Shpenzimet që nuk dëshmojnë në tërësi mund të rezultojnë në pagesa të parregullta dhe krijojnë hapësirë për mashtrim dhe marrëveshje të fshehta.

Rekomandimi 14 Kryetari i komunës duhet të sigurohet që kontrollet mbi shpenzimet për dreka zyrtare janë forcuar. Të gjitha pagesat për dreka zyrtare duhet të mbështeten me informata dhe dëshmi rreth pjesëmarrësve dhe qëllimit të organizimit.

4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhën përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollet që operojnë në nivel lokal nga Komuna kanë të bëjnë me: kontrollin e pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listën e pagave; verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve; dhe rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

Rekomandimet

Çështja 15 - Kontratat për shërbime të veçanta - Prioritet i Mesëm

E gjetura Rishikimi ynë i angazhimeve të punëtorëve me kontratë për shërbime të veçanta ka identifikuar se:

- Gjatë vitit 2014 ishin angazhuar 77 zyrtarë me kontratë për shërbime të veçanta, për të kryer detyra të shërbyesve civil me kontratë të rregullt. Kjo ka ndodhur për shkak të limitit të përcaktuar për numrin e punëtorëve të rregullt;
- Në tetë raste kontratat ishin nënshkruar pasi që punëtorët kishin filluar punën; dhe
- Në mungesë të kontratave me kompani që ofrojnë shërbime pastrimi dhe sigurimi (fizik), përmes kontratave për shërbime të veçanta ishin angazhuar 71 punëtorë për kryerjen e këtyre shërbimeve.

Rreziku Mbulimi i pozitave të rëndësishme me staf të përkohshëm dhe me kontrata të vonuara, rrit rrezikun e performacës së dobët të stafit dhe vlerë të dobët për paratë e paguar. Kjo mund të rezultojë edhe me pagesa të parregullta.

Rekomandimi 15 Kryetari i komunës duhet t'i rishikojë nevojat për angazhim të punëtorëve me kontrata për shërbime të veçanta dhe t'i forcojë kontrollet lidhur me angazhimin dhe monitorimin e këtyre punëtorëve. Asnjë pagesë s' duhet t'iu bëhet punëtorëve pa kontrata. Kryetari duhet ta shqyrtojë mundësinë për shtimin e punëtorëve të karrierës për pozitat kyçe të komunës. Kryetari duhet të sigurojë një analizë të efektivitetit mes angazhimit të punonjësve të pastrimit/rojeve dhe shërbimet jashtë kontraktuale.

Çështja 16 - Parregullsi në menaxhimin e listës së pagave - Prioritet i Mesëm

E gjetura Komuna nuk kishte arritur t'i zbatoj në mënyrë të drejtë kërkesat e rregulloreve për listën e pagave dhe si rezultat:

- Dy zyrtarë ishin paguar pas shkëputjes së kontratës. Shuma e këtyre pagesave ishte 1,804€;
- Komuna kishte proceduar me vonesë pushimin e lehonisë në gjashtë raste dhe pushimin pa pagesë në dy raste tjera. Këto raste nuk kanë rezultuar me ndikim financiar; dhe
- Në rastet e pushimit të lehonisë në sektorin e arsimit ndalesa prej 30% ishte kalkuluar gabimisht. Kjo ndalesë (30%) ishte kalkuluar në pagën bazë pa aplikuar rritjen e pagave.

Rreziku Pagesat e parregullta dhe të pasakta për paga mund të ndikojnë në presione të paparashikuara buxhetore dhe në humbje financiare për komunën.

Rekomandimi 16 Kryetari i komunës duhet inicioj një rishikim të kontrolleve mbi listën e pagave dhe të analizojë arsyet që kanë shkaktuar parregullsitë e identifikuar. Kryetari duhet të sigurojë që të forcohen kontrollet mbi listën e pagave për të siguruar aplikim efektiv të rregullave përkatëse.

Çështja 17 - Dosjet e personelit - Prioritet i Mesëm

E gjetura Rishikimi ynë ka identifikuar 15 raste të dosjeve të personelit ku mungonin dëshmitë mbi të dhënat personale, përshkrimi i standardizuar i vendit të punës, kopjet e certifikatës së shtetësisë, certifikatat që nuk janë në hetime, vlerësimet vjetore të performancës, etj.

Kontratat për 23 mësimdhënës kishin skaduar gjatë vitit 2014 dhe të njëjtat nuk ishin ripërtërirë, përderisa ata vazhdonin të punonin.

Komuna ka filluar të ndërmarrë veprime për eliminimin e kësaj situate në vitin 2015.

Rreziku Dosjet e pa kompletuara pamundësojnë një menaxhim adekuat të burimeve njerëzore dhe mund të ndikoj që të dhënat mos të jenë në gjendje t'i justifikojnë pagesat ose e pamundësojnë shqyrtimin e rezultateve nga vlerësimi i performancës. Kjo mund të rezultojë me përfitime të ulëta nga personeli dhe në vlerë të ulët për paranë e paguar.

Rekomandimi 17 Kryetari i komunës duhet të iniciojë një rishikim sistematik të dosjeve të personelit për të siguruar që të gjitha informatat e nevojshme janë përfshirë brenda një periudhe të caktuar kohe. Përveç kësaj, të marrë konfirmimin se sistematizimi i pozitave kontraktuale të mësuesve, të cilave po u referohemi më sipër, duhet të konsiderohen.

4.4.4 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Subvencionet ndahen kryesisht për entitete publike dhe entitete jo publike (individë), si bursa për studentë dhe nxënës, subvencione për sport, ndihmë me ndërtime të shtëpive në emër të gjendjes së rëndë ekonomike, ndihma në ushqim për rastet emergjente dhe ndihma tjera sociale, subvencione në bujqësi, etj. Mirëpo, gjatë vitit 2014 pjesa dërmuese e subvencioneve kishte shkuar për sistemin e kogjenerimit për nxemje të qytetit.

Rekomandimet

Çështja 18 - Mungesë e raporteve kthyesë prej përfitueseve - Prioritet i Mesëm

E gjetura Komuna kishte subvencionuar "Klubin e Hendbollit Prishtina" dhe "OJQ Stacio" me nga 3,000€. Nuk kishte pranuar raporte kthyesë se si janë shpenzuar mjetet e ndara deri në fund të vitit dhe a e kanë arritur objektivin e caktuar për çfarë janë destinuar. Komuna nuk kishte zbatuar rregulloren e brendshme për subvencione.

Rreziku Mungesa e raporteve mbi formën e shpenzimit të mjeteve shton rrezikun që mjetet nuk janë përdorur për qëllimin e caktuar. Kjo mund të rezultojë me vlerë të ulët për paranë e paguar, në dështim në arritjen e objektivave dhe në pagesa potencialisht të parregullta.

Rekomandimi 18 Kryetari i komunës duhet të sigurojë që të gjitha subvencionet janë subjekt i monitorimit efektiv dhe se aty ku kërkesat nuk respektohen merren masa adekuate si është pezullimi i pagesave.

4.5 Pasuritë dhe detyrimet

4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Pasuritë e komunës të regjistruara në SIMFK dhe të prezentuara në PVF kanë vlerën 95,175,585€. Përveç këtyre pasurive, komuna ka identifikuar dhe vlerësuar pasuri tjera në vlerë prej 2,501,447,000€. Këto pasuri ende nuk janë regjistruar në SIMFK.

Çështjen lidhur me rrezikun domethënës mbi plotësinë e pasurë ne e kemi trajtuar në pjesën 2.2.

Rekomandimet

Çështja 19 - Dobësi në regjistrimin e pasurive gjatë vitit 2014 - Prioritet i Lartë

E gjetura Përveç dobësive që kanë rezultuar me materializimin e rrezikut domethënës (pjesa 2.2.) komuna nuk ka arritur të vendosë kontrolle adekuate për regjistrim korrekt të pasurive të përfituara gjatë vitit aktual. Kjo ka ndodhur pasi që komuna nuk ka arritur ta zbatojë Rregullën Financiare 02/2013. Si pasojë:

- Pasuritë e përfituara gjatë vitit 2014 në shumë 416,778€ nuk ishin regjistruar në SIMFK; dhe
- Katër (4) situacione në vlerë 207,021€ ishin regjistruar si investime kapitale përfundimtare duke përllogaritur zhvlerësimin, përderisa do të duhej të regjistroheshin si "investim në vijim". Për më tepër, komuna nuk posedon informata të plota për të gjitha investimet në vijim.

Rreziku Kontrollat e dobëta dhe regjistrimi i mangët i pasurive të blera gjatë vitit rezulton me vlerësime të pasakta të pasurive dhe mund të ndikojnë në modifikim të opinionit.

Rekomandimi 19 Kryetari i komunës duhet të iniciojë një analizë për pengesat të cilat kanë parandaluar aplikimin e plotë të Rregullës Financiare 02/2013 gjatë vitit 2014 dhe të implementojnë procedurën të domosdoshme për të siguruar regjistrim të plotë dhe të saktë të të gjitha pasurive.

4.5.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Përshkrim

Llogaritë e arkëtueshmë janë shuma parash të cilat të tjerët ia kanë borxh komunës. Komuna e Prishtinës ka një nivel të lartë të të arkëtueshmeve që përbëhen nga borxhi historik dhe borxhet e krijuara gjatë vitit 2014. Shuma e të arkëtueshmeve që është raportuar në PVF-të e vitit 2014 është 43,171,820€. Kjo shumë përfaqëson tri (3) grupe kryesore të të arkëtueshmeve:

- Tatimi në pronë: 36,923,805€;
- Taksa për leje të ndërtimit dhe legalizime: 6,237,789€; dhe
- Shfrytëzimi i pronës komunale: 10,225€.

Krahasuar me vitin e kaluar, kur të arkëtueshmet e raportuara ishin 44,498,000€, vërehet një zvogëlim për 1,326,000€ që kryesisht përbëhet nga të arketushmet nga lejet e ndërtimit.

Rekomandimet

Çështja 20 - Nivel i lartë i të arkëtueshmeve - Prioritet i Lartë

E gjetura Edhe përkundër zvogëlimit të të arkëtueshmeve këtë vit, komuna vazhdon të përballlet me nivel të lartë të të arkëtueshmeve historike. Ky nivel i të arkëtueshmeve është rezultat i mungesës së një procesi sistematik për ta nxitur dhe zbatuar mbledhjen e borxheve.

Rreziku Një qasje joefektive për mbledhjen e borxhit, për komunën do të rezultojë në humbje financiare; do t'i zvogëloj mundësitë e investimeve; dhe vendos një precedent të keq ku mospagesa mund të bëhet normë.

Rekomandimi 20 Kryetari i komunës duhet të sigurojë një vlerësim i të arkëtueshmeve historike është përfunduar duke i identifikuar dhe dokumentuar rastet që mund të trajtohet si borxh i keq dhe të bëjë shlyerjen e tij. Pjesa e mbetur e borxheve, barrierat në inkasim duhet të adresohen përmes mekanizmave adekuat përfshirë veprimet ligjore.

4.5.3 Trajtimi i borxheve

Përshkrim

Borxhet e komunës përfaqësojnë detyrimet e papaguara ndaj furnitorëve që duhet të paguhet në të ardhmen. Në fund të vitit 2014 shuma e këtyre borxheve ishte 1,192,224€. Kjo shumë ka shënuar një rritje krahasuar me vitin 2013 që ishte 1,155,370€. Është e pakuptimtë ngritja e borxheve përderisa viti 2014 kishte përfunduar me mjete të pashpenzuara në shumicën e kategorive, ashtu siç shihet në kapitullin 4.2.

Përveç borxheve, komuna ka detyrime kontingjente lidhur me konteste të ndryshme gjyqësore që parallogariten 3,110,000€. Komuna është duke e zhvilluar qasjen e saj për trajtimin e këtyre detyrimeve dhe e ka të qartë mundësinë e shndrrimit të detyrimeve kontingjente në obligime dhe keqësimit të situatës financiare të komunës nga kjo. Vetëm në një kontest të humbur në vitin 2014, komuna kishte paguar 1,700,000€. Ne do vazhdojmë t'i monitorojmë veprimet e komunës në këtë fushë.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm dhe për shkak të rëndësisë së tij ne e prezantojmë këtu veçmas. Ne e marrim parasysh fushëveprimin e punës së Auditimit të Brendshëm (AB) dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit (KA). Përveç kësaj, ne i shqyrtojmë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë, si rezultat i punës së kryer nga auditimi i brendshëm dhe KA

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) gjatë vitit 2014 përbëhej nga tre (3) anëtarë (përfshirë drejtorin). Bashkëpunimi ndërmjet NjAB-së dhe menaxhmentit ishte tejet i dobët, që kishte pasuar me largimin e drejtorit të kësaj njësie në vitin 2015.

Rekomandimet

Çështja 21 - Përfitim i dobët nga NjAB - Prioritet i Lartë

E gjetura Rishikimi ynë ka identifikuar se janë realizuar vetëm katër (4) nga njëmbëdhjetë (11) auditime të planifikuara dhe menaxhmenti ka dështuar për t'i përgatitur planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të NJAB. Mungesa e Komitetit të auditimit është trajtuar në pjesën 4.1.

Rreziku Kontributi i dobët i NJAB do të rezultoj që AB mos t'i ofrojë menaxhmentit nivelin e kërkuar të sigurisë mbi funksionimin efektiv ose mosfunksionimin e sistemeve kryesore financiare. Mos adresimi i rekomandimeve të AB-së rezulton në vazhdim të dobësive në sistemet kryesore të kontrollit të brendshëm, në joefikasitet të vazhdueshëm të organizatës, humbje financiare për komunën dhe në vlerë të dobët për para.

Rekomandimi 21 Kryetari i komunës duhet të vendosë funksionim të plotë të Sistemit të Auditimit të Brendshëm dhe të siguroj numrin dhe kualitetin e duhur të auditimit të brendshëm Kjo duhet ta pasqyrojë një zbatim në tërësi të rrezikut të bazuar në Auditimin Strategjik dhe Planin Vjetor dhe statutin e KA-së. Kryetari duhet të përcjellë implementimin e sistemit dhe rezultatin e tij.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe

Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare. 158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

Të përfshihet menjëherë pas opinionit;

Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;

Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;

Të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2013	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
1. Pasuritë - rreziqet domethënëse	1. Kryetari i komunës duhet t'i analizojë arsyet për keqdeklarimin fillestar të pasurive dhe për mos ndjekjen e këshillës së ZAP-it për ta adresuar këtë. Duhet të ndërmerren aktivitete adekuate për t'u siguruar që regjistrimi i pasurive në SIMFK do të procedohet gjatë muajve në vijim dhe do të harmonizohet me shifrat e PVF-ve të vitit 2014			Jo
2. IK&MSH - Keqklasifikimi i shpenzimeve	2. Kryetari i komunës duhet të përcaktojë pse ka ndodhur keqklasifikimi material i identifikuar në mes të investimeve kapitale dhe mallrave dhe shërbimeve dhe të zbatojë kontrolle të reja apo t'i shtojë ato për të siguruar një klasifikim të drejtë të shpenzimeve në të ardhmen.			Jo
3. Prezantimi i PVF	3. Kryetari i komunës duhet të sigurojë që plani i përgatitjes të PVF-ve 2014 në mënyrë formale ta përfshijë rishikimin e draft pasqyrave nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në pajtueshmërinë me kërkesat e thesarit dhe fushat që konsiderohen që janë të rrezikut të lartë si dhe fushat ku janë identifikuar gabime në vitet paraprake. Deklarata e nënshkruar nga Kryetari dhe ZKF nuk duhet nënshkruar derisa kontrollet e nevojshme janë aplikuar në draft të PVF-ve.			Jo
4. Obligimi për raportim të jashtëm	4. Kryetari i komunës duhet të sigurojë se kërkesat e raportimit të jashtëm janë përmbushur plotësisht në vitin 2014, duke siguruar se kërkesat janë identifikuar sistematikisht si dhe të bëhet raportimi i			Jo

	arritjeve dhe monitorimeve të tyre.			
4.1 Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak	5. Kryetari i komunës duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, në mënyrë të qartë përcakton një afat kohor praktik por sfidues për adresimin e rekomandimeve të ZAP-it me anëtarët e stafit llogaridhënës, të identifikuar me fokus fillestar në ato të një rëndësie të madhe. Implementimi i këtij plani duhet të monitorohet nga Kryetari në baza mujore.		Vetëm një pjesë e rekomandimeve janë adresuar	
5. Ekzekutimi i buxhetit	6. Kryetari i komunës duhet të sigurojë se përgatitja e buxhetit paraprihet me një proces rigoroz të vlerësimit i cili pasqyron në mënyrë të plotë informatat përfshirë shpenzimet e vitit të kaluar/ndryshimet e pritura të vitit, etj. Performanca e buxhetit duhet të monitorohet në baza mujore dhe të adresohen barrierat e identifikuar në ekzekutimin e niveleve të planifikuara të buxhetit me fokus të veçantë në projektet kapitale. Buxheti i të hyrave vetanake duhet të përfshijë pranimet maksimale të mundshme.			Jo
6. Të hyrat -nga tatimi ne prone dhe taksa biznesit	7. Kryetari i komunës duhet të zbatojë rishikim sistematik për të përcaktuar barrierat për rritjen e shkallës aktuale të inkasimit të të hyrave dhe për zvogëlimin e shkallës së borxheve historike (duke përfshirë borxhet e tatimin për biznes) si dhe të identifikojë mundësitë për përmirësim të situatës. Referenca duhet të bëhen me komunat tjera të ngjashme për të përcaktuar nëse praktikat efektive në vende të tjera mund të zbatohen në nivel lokal. Duhet të kryhet një kontroll i veçantë për të konfirmuar vlerën e borxheve historike.		Vërehet një përmirësim te tatimi në pronë, por pjesa tjetër e të hyrave është e ngjashme me vitet e kaluara.	
7. Dobësitë sistematike ne prokurim.	8. Kryetari i komunës duhet të identifikojë arsyen e vonesave në kontrata dhe të gjej mënyrat për përmirësime në menaxhim të kontratave. Këto duhet të zbatohen menjëherë dhe t'i nënshtrohen			Jo

	rishikimit të rregullt nga menaxhmenti. Të gjitha ndëshkimet duhet zbatohen sipas kushteve kontraktuale. Për më tepër, Kryetari duhet të konfirmojë se çështjet e identifikuar nuk janë të përhapura edhe nëpër kontratat tjera.			
8. Dobësitë jo-sistematike të prokurimit .	9. Kryetari i komunës duhet të siguroj që para fillimit të proceseve të prokurimit janë kryer përgatitjet adekuate dhe janë eliminuar pengesat si kontestet pronësoro juridike dhe çështjet e objekteve ku do të kryhen furnizimet për të garantuar një shpenzim efikas të parasë. Për më tepër, Kryetari duhet të konfirmojë se çështjet e identifikuar nuk janë të përhapura edhe nëpër kontratat tjera.			Jo
9. Tejkalimi i numrit të punësuarve.	10. Kryetari i komunës duhet të siguroj se kërkesat e stafit vlerësohen me saktësi në bazë vjetore dhe të pasqyrohen në parashtrimet buxhetore. Kontratat duhet të ipen vetëm kur ekziston financimi.	Po.		
10. Punëtor të punësuar me kontratë për shërbime të veçanta .	11. Kryetari i komunës duhet të vlerësojë nivelin e punësimeve të parregullta dhe ndërmer veprimet e duhura për rregullimin e statusit të punës të punonjësve–implementimin e procedurave të nevojshme të rekrutimit.			Jo
11. Dobësitë e rregullore për ndarje të subvencioneve .	12. Kryetari i komunës duhet të rishikojë rregulloren aktuale të subvencioneve, për të përcaktuar se cilat përmirësime kërkohen për ta bërë këtë ‘t’i përshtatet qëllimit’. Pastaj një rregullore e rishikuar duhet të ridorëzohet në Kuvend për miratim, më së voni deri në fund të vitit.	PO		

12. Mungesa e marrëveshjeve për subvencionet dhe dobësitë në monitorim .	13. Kryetari i komunës duhet të sigurojë se nuk do të paguhet asnjë subvencion pa ndonjë marrëveshje formale e nënshkruar nga komuna dhe përfituesi, e cila në mënyrë të qartë përcakton kërkesat e llogaridhënjes së përfituesit. Për më tepër, Kryetari duhet të konfirmojë se çështjet e identifikuar nuk janë të përhapura edhe tek subvencionet tjera.		Edhe këtë vit janë identifikuar disa dobësi në mbikëqyrjen e subvencioneve	
13. Menaxhimi i dobët i llogarive të arkëtushme	14. Kryetari i komunës duhet të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim gjithëpërfshirës i qasjes së aplikuar tek të arkëtueshmet dhe t'i identifikojë barrierat në përmirësimin e shkallës së mbledhjes dhe të kërkojë veprime për t'i adresuar këto. Duhet të zbatohen rregullore të zgjeruara që do të caktonin qasje të qartë dhe praktike për të siguruar një qasje të hershme dhe efektive për maspagesen duke përfshirë veprime ligjore dhe ndërprerje të shërbimeve sipas nevojës.		Vërehet një ulje e nivelit të të arkëtueshmeve, por saldo historike vazhdon të jetë e lartë	Jo
14. Obligimet e pa prezantuar në PVF	15. Kryetari i komunës duhet të implementojë procedura të zgjeruara për të siguruar se departamenti i financave mban evidenca të plota dhe të sakta të obligimeve ashtu edhe të prezantojë ato në mënyrë të saktë në PVF.	Po .		
15. Njësia e Auditimit të Brendshme dhe Komiteti i Auditimit	16. Kryetari i komunës duhet t'i rishikojë në mënyrë kritike burimet dhe fokusin e NjAB-së. Duhet të përcaktohen arsyet e rezultateve të kufizuara në vitin 2013. Një plan i auditimit i bazuar në rrezik duhet të aplikohet për pjesën e mbetur të 2014 dhe në vitet e ardhshme, NjAB të mbështetet me staf shtesë. Komiteti i Auditimit duhet të rishikojë përmbajtjen dhe cilësinë e planeve të NJAB-së, si dhe të mbështes implementimin efektiv të rekomandimeve.			Jo

Shtojca III: Përgjigja e Menaxhmentit ndaj të gjeturave të ZAP-it

Te gjeturat	Pajtohem po/jo	Komentet nga Institucioni i audituar ne rast te mospajtimit	Pikëpamja e ZAP-it
Çështja 14	Jo	Komenti: E gjetura qe pagesat per dreka zyrtare nuk kane pasur informata per qëllimin e drekës zyrtare eshte e pasakte. Nga dëshmitë e ofruara gjate procesit te auditimit (mostrat), shihet qe per rastet e permenduar ka qene i specifikuar qarte qëllimi i drekave zyrtare. Ndersa konstatimi per mungese te listës se pjesëmarrësve qëndron.	Ne synojmë që fondet publike të përdoren vetëm për arritjen e objektivave të komunës. Kjo mund të vërtetohet me gjurmë dhe dëshmi të qarta dhe të mjaftueshme Në këtë rast ka qenë e qartë që shpenzimi ishte për dreka zyrtare me një delegacion, por mungonin dëshmitë shtesë dhe të mjaftueshme, siç ceket në raport, mbi qëllimin/përfitimin e komunës në këtë rast.